



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1/2022

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevi kryesues, Franciska Zhitija Ymeri dhe Arsim Hamzaj, anëtarë duke vendosur lidhur me apelin e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Vendimit nr. 01/1577-2022 të datës 05.12.2022, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, me objekt të çështjes mos certifikimi i 14 kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend Komunal në Komunën e Leposaviqit, që do të mbahen më datën 25 dhjetor 2022, në seancën e Panelit të mbajtur më 08.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET i bazuar apeli i subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.1/2022 i datës 06.12.2022, ashtu që **ANULOHET**, vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me seli në Prishtinë nr. 01/1577-2022 datë 05.12.2022, dhe **çështja kthehet në rivendosje në KQZ**.

A r s y e t i m

Më datën 06.12.2022 PZAP-i, ka pranuar një apel nga pala ankuese, në të cilin kërkon që të anulohet vendimi i KQZ-së, nr. 01/1577 – 2022 i datës 05.12.2022, për mos-certifikimin e 14 kandidatëve nga lista e LVV-së, për Kuvendin Komunal në Leposaviq, për zgjedhjet lokale të datës 25 dhjetor 2022. Pasi që me vendimin e ankimuar KQZ-ja, nuk e ka pranuar listën në tërësi të subjektit ankues për sa i përket anëtarëve të kuvendit komunal për zgjedhjet e lartcekura edhe pse sipas ankuesit i njëjtit kishte vepruar konform udhëzimeve që Zyra e kishte kthyer në korrigjimin listën e subjektit ankues, me propozim që PZAP-i, të pranoj si të bazuar apelin, të anulohet vendimi i ankimuar i KQZ-së dhe të certifikohen edhe 14 kandidatët në listën e propozuar nga subjekti ankues.

Më datën 07.12.2022, KQZ-ja, përmes përgjigjes në apel thekson se, brenda afatit të paraparë me Planin Operacional, të aprovuar nga KQZ-ja, afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve për subjektet politike dhe kandidatëve të tyre, ishte data 2 dhjetor 2022 deri në ora 16:00. Zyra ka

pranuar aplikimet për certifikim nga subjekti ankues me gjithsej 4 kandidatë, dhe në përputhje me procedurat e verifikimit të materialeve të dorëzuara nga subjektit politik ankues, ka vërejtur në listën e kandidatëve për Kuvend Komunal në Leposaviq, të këtij subjekti politik, se fillimisht janë dorëzuar vetëm emrat e katër (4) kandidatëve, dhe nuk kanë respektuar kuotën gjinore, ku partisë politike në fjalë më datën 3 dhjetor 2022, i është dërguar shkresë për korrigjim të listës në mënyrë që kjo listë të jetë në përputhje me kërkesat ligjore. Ndërsa më datën e njëjtë pra më 3 dhjetor 2022, subjekti politik ankues, e ka dorëzuar listën e korrigjuar respektivisht të zgjeruar me tetëmbëdhjetë (18) kandidat, nga katër (4), kandidatë sa ishin paraprakisht. Zyra pas verifikimit të listës së korrigjuar me kandidatë i ka rekomanduar KQZ-së, që ti certifikon, mirëpo KQZ-ja, i ka certifikuar vetëm 4 kandidatë sa fillimisht i kishte propozuar subjekti ankues por jo edhe kandidatët e tjerë që i kishte propozuar pasi që ishte kthyer lista në korrigjim.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, vlerësimit të vendimit të ankimuar që është objekt lëndor, përgjigjes në apel të KQZ-së dhe duke u bazuar në nenin 115 paragrafi 1, nenin 118 paragrafi 1 dhe nenin 122 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, gjeti se **apeli është i bazuar**, për këto arsye:

Në këtë rast, nuk është kontestuese se subjekti ankues deri më datën 02.12.2022, i kishte dorëzuar në Zyre – në KQZ, listën me katër kandidatë për tu certifikuar në zgjedhjet e lartcekura, nuk është kontestuese se Zyra më datë 03.12.2022, ia kishte kthyer në korrigjim listën e subjektit ankuese sepse nuk e kishte respektuar kuotën gjinore, me rastin e paraqitjes së listës së kandidatëve, nuk është kontestuese se subjekti ankues e kishte korrigjuar listën e kandidatëve brenda afatit të përcaktuar nga zyra.

Kontestuese në këtë çështje juridike, mbetet e drejta e subjektit ankues, që ta zgjeron listën e kandidatëve për të garuar zgjedhje dhe për ti certifikuar edhe me kandidatë të tjerë, pasi që iu është dhënë mundësia për ta korrigjuar listën nga zyra sepse fillimisht subjekti ankues i kishte dorëzuar katër kandidatë për tu certifikuar, ndërsa pas korrigjimit të listës i ka dorëzuar dhe propozuar për në garë 18 kandidatë.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur më datën 05.12.2022, ka refuzuar rekomandimin e Zyrës për certifikimin e katërmëdhjetë (14), kandidatëve të subjektit politik ankues, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend Komunal në Komunën e Leposaviqit, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

Në arsyetim të vendimit të ankimuar, KQZ-ja ka theksuar se subjekti ankues, e ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për certifikim të kandidatëve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend Komunal në komunën e Laposaviqit, më datën 2 dhjetor 2022. Me rastin e kalimit të afatit për aplikim dhe certifikim në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, Zyra ka raportuar në KQZ, se subjekti politik ankues, ka aplikuar për certifikim për Kuvend Komunal në Komunën e Laposaviqit, me katër (4) kandidatë. Në përputhje me procedurat Zyra, ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar dhe ka vërejtur që subjekti ankues, nuk e ka respektuar kuotën gjinore me rastin e dorëzimit të listës. Brenda afatit të përcaktuar me Planin Operacional të KQZ-së, Zyra ka dërguar shkresë tek subjekti ankues për korrigjim të listës subjekti ankues duke vepruar brenda afatit të caktuar nga Zyra, ka dorëzuar listën e korrigjuar, duke i përfshirë tetëmbëdhjetë (18) kandidat. Më këtë rast KQZ, ka vlerësuar se katërmëdhjetë (14) kandidatët shtesë janë dorëzuar pas mbylljes së afatit për aplikim dhe certifikim, andaj KQZ-ja vendosi që të mos i certifikoj katërmëdhjetë 14 kandidatë të tjerë, sipas listës së dorëzuar nga subjekti ankues pasi që lista e këtij subjekti ishte kthyer në korrigjim.

Paneli vlerëson se Zyra, kishte vepruar drejt që fillimisht e kishte kthyer në korrigjimin listën e subjektit ankues për sa i përket kuotës gjinore që duhet të respektohet dhe të plotësohet brenda çdo liste të subjekteve garuese. Zyra, kishte vepruar drejt dhe në harmoni me legjislacionin zgjedhor, që pas pranimit të listës së korrigjuar nga subjekti ankues, ku ishin shtuar dhe propozuar nga subjekti edhe 14 kandidat, e që gjithsejtë tani janë 18 kandidatë, në garë për anëtarë të kuvendit komunal, për zgjedhjet e lart cekura, që secilin prej këtyre kandidatëve zyra e ka procesuar në listë për verifikimet që duhet të kryhen në Shërbimin Votues brenda KQZ-së, si dhe verifikimet tjera që kërkohen për tu plotësuar kushti ligjor për kandidatët që garojnë në zgjedhje, në kuptim të nenit 29 të LZP-së. Pas përfundimit të procedurave të lartcekura lidhur me kandidatët e subjektit ankues Zyra, me të drejt i kishte rekomanduar KQZ-së, që ti certifikoj 18 kandidatët e propozuar nga subjekti ankues, pasi që të njëjtit sipas Zyrës i plotësonin kushtet ligjore për të garuar në zgjedhje.

Paneli, vlerëson se subjektit ankues pasi që iu është dhënë mundësia nga Zyra, për ta korrigjuar listën, e që Paneli është në dijeni se lista është kthyer në korrigjim nga Zyra, tek subjekti ankues vetëm për sa i përket korrigjimit të kuotës gjinore të kandidatëve brenda listës së kandidatëve të propozuar. Mirëpo në këtë rast Paneli vlerëson se subjektit ankues i ka lindur afati i ri për ta korrigjuar listën e kandidatëve të propozuar paraprakisht që më këtë rast subjekti ankues e ka zgjeruar listën e kandidatëve që do të garojnë në zgjedhjet e lartcekura edhe për 14 kandidatë të

tjerë. Për Panelin ky korrigjim respektivisht zgjerimi i listës është në harmoni edhe me planin operacional të KQZ-së dhe me Rregullën Zgjedhore nr.8/2013, sepse nuk ka asnjë dispozitë ligjore që e përcakton se pas kthimit të listës së korrigjuar, subjektit politik ti ndalohet që listën ta zgjeron edhe me kandidatë të tjerë, siç ka ndodhur në rastin konkret. Më tej Paneli vlerëson se në këtë rast respektivisht me zgjerimin e listës së kandidatëve nga subjekti ankues, nuk minohet aspak procesi zgjedhor, përkundrazi votuesit potencial kanë mundësi dhe alternativa që të kanë më shumë mënyra për të zgjidhur kandidatët të cilët do ti votojnë.


Nga arsyet e cekura Paneli, vendosi që ta pranoi apelin e subjektit ankues, vendimin e ankimuar të KQZ-së ta anuloi dhe çështjen ta kthej në rivendosje KQZ-së, ku KQZ në ri procedurë ka për obligim që ta rishqyrton rekomandimin e Zyrës edhe për 14 kandidatët, të cilët nuk janë certifikuar nga KQZ-ja, e që janë propozuar për certifikim nga subjekti ankues, andaj pas vlerësimit dhe verifikimit nga Zyra, dhe plotësimit të kushteve ligjore nga neni 29 i LZP-së, duke respektuar kuotën gjinore, të merret vendim i drejt dhe i ligjshëm.

Në pajtim me nenin 115 par.1 lidhur më nenin 118 par.1 dhe 122 par.3 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1/2022 më datën 08.12.2022

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, bazuar në nenin 118 par. 4 të LZP-së.